VENDIM
Nr.288, datë 28.4.2010

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.716, DATË 23.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.693, DATË 10.11.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHPALLJEN E KOMPLEKSIT LIGATINOR TË BUTRINTIT "PARK KOMBËTAR""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.716, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në vendimin nr.693, datë 10.11.2005 të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit "Park Kombëtar"".
2. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha